

Vendim nr. 187 datë 15.07.2025

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahimimi, anëtarë, në datën 15.07.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 1 (J) 2025 të Regjistrisë Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: JEHONA ZHUKA

OBJEKTI: Anulimi i ligjit nr. 82, datë 26.07.2024 “Për Policinë e Shtetit”, pasi në këtë ligj nuk përfshihet shpërblimi i fëmijëve deri në moshën 18 vjeç të punonjësve të Policisë së Shtetit, të cilët aksidentohen në punë dhe të cilëve ua njeh Instituti i Sigurimeve Shëndetësore aksidentimin në punë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, 33, 35, 42, 49, 57, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, shkronja “i” dhe 145 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nenet 2, 6 dhe 8 të Protokollit nr. 1 të saj; nenet 2, 20, 21, 27, 28, 31, 32, 33, 34, 38, 39, pika 1, shkronjat “a” dhe “b” dhe pikat 3 dhe 4, 42, 43 e vijues, 71, pika 1, shkronjat “a” dhe “b”, 71/c, pikat 1, 2 dhe 3, 72, 76, pikat 1 dhe 6, 81 dhe 86, pika 3, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr.8577/2000*).

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Jehona Zhuka është bashkëshortja e të ndjerit G.Zh., i cili ka qenë punonjës i Policisë së Shtetit, me detyrë “përgjegjës turni”, në pikën e kalimit kufitar të Hanit të Hotit, Shkodër. Në datën 16.06.2023, duke u kthyer nga qyteti i Shkodrës për në Tiranë ku ishte me banim, në aksin rrugor Balldre-Lezhë, gjatë kohës që ky shtetas ka qenë në drejtimin e mjetit të tij ka ndodhur një aksident rrugor me pasojë vdekjen e tij. I ndjeri G.Zh. ka lënë pas bashkëshorten dhe dy fëmijë.

2. Ligji nr. 108, datë 31.07.2014 “Për Policinë e Shtetit” (*ligji nr. 108/2014*), i ndryshuar, në fuqi në kohën e ndodhjes së aksidentit, në nenin 75 të tij rregullonte trajtimin e familjarëve të punonjësve të rënë për shkak të detyrës dhe përfitimet e tyre.

3. Në gusht të vitit 2024 ka hyrë në fuqi ligji nr. 82, datë 26.07.2024 “Për Policinë e Shtetit” (*ligji nr. 82/2024*), i cili, me nenin 141, ka shfuqizuar ligjin nr. 108/2014 dhe çdo akt tjetër nënligjor që bie në kundërshtim me këtë ligj. Në nenin 111 të ligjit rregullohet trajtimi i familjarëve të punonjësve që humbin jetën për shkak të detyrës, të cilët përfitojnë: a) ndihmë të menjëhershme financiare deri në 10 paga mujore, sipas pagës referuese të muajit të fundit; b) pension familjar suplementar në masën 100 % të pagës mujore të muajit të fundit kalendarik të shërbimit, pavarësisht nga periudha e sigurimit. Përfitimet jepen në vlerën 100 % të pagës, sa herë që paga, sipas së cilës është llogaritur ky përfitim, ndryshon; c) rimbursim në masën 100 % të bursës së studimit në institucionet e arsimit publik për fëmijët e punonjësit; ç) banesë falas për bashkëshorten/in dhe fëmijët kur janë të pastrehë, sipas procedurave të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave; d) ndihmë financiare në masën e 1 page mujore, sipas pagës referuese, çdo përvjetor vdekjeje; dh) organizimin e ceremonisë mortore nga drejtuesi i strukturës dhe shpenzimet paguhen nga buxheti i Policisë; e) punësim me prioritet në përputhje me arsimimin, përvojën dhe kritere të tjera të nevojshme për vendin e punës. Sipas pikës 2 të këtij neni rregullat dhe procedurat e trajtimit të familjarëve të punonjësve, që humbin jetën për shkak të detyrës, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Në datën 16.02.2025 shtetasi Sh.Zh., babai i të ndjerit G.Zh., i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për shfuqizimin e ligjit nr. 82/2024. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 94, datë 15.04.2025, ka vendosur mospranimin e kërkesës, pasi ka vlerësuar se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae*, për shkak se nuk justifikon interesin e tij, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës dhe nenit 49, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000.

5. Në datën 12.05.2025 kërkuësja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, duke kundërshtuar, gjithashtu, parashikimet e ligjit nr. 82/2024.

II

Pretendimet e kërkuësjes

6. **Kërkuësja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se ligji nr. 82/2024 duhet të shfuqizohet dhe të parashikohet në të që për punonjësit e Policisë së Shtetit që humbin jetën aksidentalisht dhe ngjarja njihet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore si aksident në punë, fëmijëve jetimë deri në moshën 18 vjeçare t'u jepet paga e plotë e prindit ose të detyrohet Këshilli i Ministrave që me vendim të veçantë, siç është rasti i kërkuësjes, të shpërblehen këta fëmijë me pagën e plotë të të atit të tyre. Bashkëshorti i kërkuësjes është aksidentuar pasi ka përfunduar një pune të lodhshme prej 20 orësh dhe nëse shteti do t'i kishte siguruar atij transport me furgon ose autobus, ai aksident nuk do të kishte ndodhur. I ndjeri ka lënë pas bashkëshorten (kërkuësen) dhe dy fëmijë që janë në kushte të vështira ekonomike e që kanë nevoja të veçanta. Edhe pse kërkuësja ka kërkuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit që fëmijëve t'u jepej pension në masën 100% të pagës së të atit të tyre, përgjigja ka qenë që ky pension jepet vetëm për ata që janë vrarë me armë dhe se në ligjin e ri do të shtohet një dispozitë për ata që vriten aksidentalisht në detyrë. Edhe pse i ati i të ndjerit u është drejtuar me kërkesë me shkrim disa institucioneve, funksionarëve publikë dhe deputetëve në ligjin e ri nuk u bënë këto ndryshime.

III

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

A. Për legjitimitetin e kërkuësjes

7. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

8. Kur objekt i ankimit kushtetues individual është shfuqizimi i ligjit ose aktit normativ, bazuar në nenet 49, pika 3, shkronja “e” dhe 71, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000,

kërkuesi legjitimohet nëse plotëson bashkërisht këto kritere: (i) legjitimimi *ratione personae*, në kuptimin që individi provon se është bartës i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar, si dhe provon interesin në lidhje me çështjen, pra cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të së drejtës kushtetuese; (ii) shterimi i mjeteve juridike efektive për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar ose individi provon se akti i kundërshtuar është drejtpërdrejt i zbatueshëm; (iii) legjitimimi *ratione temporis*, në kuptimin që individi ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit; (iv) legjitimimi *ratione materiae*, në kuptimin që individi provon se pretendimet e ngritura janë të tilla që bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, pra të drejtat dhe liritë themelore, që pretendohen se janë cenuar, janë të garantuara në Kushtetutë, si dhe shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur (shih vendimet nr. 34, datë 12.06.2023; nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese).

9. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative ndaj mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuesin. Po kështu, mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së tyre, me pasojë moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kriterëve të tjera. Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson të theksojë se në rastin kur verifikohet dhe arsyetohet mosplotësimi i vetëm një kriteri, kjo vjen si rezultat i zbatimit të karakterit kumulativ të tyre dhe nuk nënkupton se kriteret e tjera paraprake humbasin rëndësinë që kanë për rezultatin e çështjes.

10. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuesja është bashkëshortja e ish-punonjësit të Policisë së Shtetit, të ndjerit G.Zh., i cili ka humbur jetën në vitin 2024, në një aksident rrugor, pasi kishte lënë detyrën e tij, gjatë kohës që ishte duke u kthyer për në Tiranë, ku ishte me banim, duke lënë pas edhe dy fëmijë të mitur të moshave 12 vjeç dhe 16 vjeç. Në kohën e ndodhjes së kësaj ngjarjeje ka qenë në fuqi ligji nr. 108/2014, i cili në nenin 75 të tij përcaktonte edhe përfitimet e pjesëtarëve të familjes të punonjësit të policisë që humb jetën për shkak të detyrës. Referuar përmbajtjes së ankimit kushtetues individual, nuk rezulton që fëmijët e të ndjerit G.Zh. të kenë përfituar nga ky ligj.

11. Në vitin 2024 është miratuar ligji i ri i posaçëm nr. 82/2024, i cili ka shfuqizuar ligjin nr. 108/2014, por ai, në nenin 111, përmban të njëjtat parashikime të ligjit të mëparshëm për sa i takon trajtimin të familjarëve të punonjësve të policisë që humbin jetën për shkak të detyrës.

12. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se ligji nr. 82/2024 nuk ka përcaktuar dhe as nuk ka përkufizuar se cilat janë ato raste që konsiderohen “*humbje jete për shkak të detyrës*”, ndërkohë që sipas pikës 2 të nenit 111 të këtij ligji rregullat dhe procedurat e trajtimit të familjarëve të punonjësve, që humbin jetën për shkak të detyrës, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Nga ana tjetër, kërkuesja, edhe pse pretendon se u është drejtuar strukturave të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, nuk ka paraqitur bashkëlidhur ankimit kushtetues individual asnjë akt të organit administrativ për mënyrën e zbatimit të ligjit të mëparshëm, ashtu edhe të ligjit të ri në fuqi objekt ankimi, pra se ajo nuk është subjekt përfitues për shkak të mospërfshirjes së ish-bashkëshortit tek ata punonjës që kanë humbur jetën për shkak të detyrës dhe as ndonjë akt provues në lidhje me mënyrën e zbatimit të këtij ligji në raste të ngjashme.

13. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se ligji i kundërshtuar ka parashikuar garancitë dhe përfitimet për një kategori të familjarëve të punonjësve të policisë, por ai nuk rezulton të jetë i vetëzbatueshëm, çka nënkupton se për zbatimin e tij është e nevojshme dalja/miratimi i akteve administrative të organeve përgjegjëse. Në këtë kuptim, kërkuesja nuk ka parashtruar dhe argumentuar nëse për ish-bashkëshortin e saj është njohur apo refuzuar statusi i “të rënit në detyrë”, pra nuk ka paraqitur një akt individual negativ (ndalues) të ndonjë organi publik dhe, në vijim, nëse ajo ka pasur apo jo mjete në dispozicion për të kundërshtuar një akt të tillë administrativ me mjetet ligjore të ankimit që njeh legjislacioni në fuqi, apo nëse këto mjete ligjore ka qenë joefektive. Mbledhja e Gjyqtarëve arrin në përfundimin se ndonëse *prima facie* duket se ligji i kundërshtuar ka një parashikim ndalues për rastin e kërkueses, i cili mund të kufizojë të drejtat e pretenduara prej saj dhe fëmijëve të mitur, u takon në radhë të parë autoriteteve ligjzbatuese dhe, më tej, gjykatave të juridiksionit të zakonshëm që të interpretojnë e të zbatojnë dispozitat e ligjit nr. 82/2024 dhe të akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi, duke pasur në vëmendje qëllimin për miratimin e këtyre dispozitave dhe rrethanat e rastit konkret, përfshirë edhe situatën e gjendjen ekonomike, shëndetësore e sociale, si dhe nevojat e veçanta të kërkueses dhe fëmijëve të saj.

14. Mbledhja e Gjyqtarëve, duke pasur parasysh edhe natyrën subsidiare të gjykimit kushtetues, çmon se ajo nuk mund të zëvendësojë organet e tjera të pushtetit publik në ushtrimin e kompetencave të tyre dhe as të shprehet përpara se vetë këto organe t'i japin kuptim normës ligjore të zbatueshme në një rast konkret të caktuar. Për më tepër, ajo çmon se autoritetet publike kanë të gjitha hapësirat dhe mundësitë, ashtu edhe detyrimin, që t'i japin normës ligjore, edhe përmes interpretimit në frymë të saj, atë kuptim që garanton gëzimin e të drejtave ligjore të individëve në kuptim edhe të parimeve të shtetit të së drejtës dhe të sigurisë juridike.

15. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se kërkesja nuk legjitimohet t'i drejtohet kësaj Gjykate, pasi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar. Për rrjedhojë, kërkesa nuk plotëson kushtet dhe kriteret formale ligjore të parashikuara në ligj dhe, si e tillë, nuk mund të pranohet për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin paraprak të çështjes që i përket ankimit kushtetues individual të paraqitur nga kërkuesja Jehona Zhuka, me objekt shfuqizimin e ligjit nr. 82/2024, vlerësojmë se çështja duhej të kalonte për shqyrtim në seancë plenare, mbështetur në argumentet e mëposhtme.

2. Kërkuesja është bashkëshortja e ish-punonjësit të Policisë së Shtetit, të ndjerit G.Zh., i cili ushtronte detyrën e përgjegjës të turnit në pikën e kalimit kufitar të Hanit të Hotit, Shkodër. Në datën 16.06.2023 bashkëshorti i kërkueses po kthehej nga qyteti i Shkodrës për në Tiranë ku ishte me banim, pasi kishte lënë detyrën dhe pas një pune të lodhshme prej 20 orësh dhe gjatë drejtimit të mjetit ka humbur jetën në një aksident automobilistik në aksin rrugor Balldre-Lezhë. Ai ka lënë pas bashkëshorten dhe dy fëmijë të mitur, të cilët, nga sa konstatohet nga aktet bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, janë në kushte të vështira ekonomike dhe me nevoja të veçanta.

3. Në kohën e ndodhjes së ngjarjes ka qenë në fuqi ligji nr. 108/2014, i cili në nenin 75 të tij përcaktonte edhe përfitimet e pjesëtarëve të familjes së punonjësit të policisë që ka humbur jetën për shkak të detyrës. Sipas kësaj dispozite, familjarët e punonjësit të policisë që humb jetën për shkak të detyrës trajtohen me ndihmë të menjëhershme financiare, deri në 10 paga mujore, sipas pagës referuese të muajit të fundit; pension familjar suplementar, në masën 100 për qind të pagës mujore të muajit të fundit kalendarik të shërbimit, pavarësisht nga periudha e sigurimit; rimbursim, në masën 100 për qind të bursës së studimit në institucionet e arsimit shtetëror për fëmijët e punonjësit; banesë falas për bashkëshorten/in dhe fëmijët kur janë të pastrehë, sipas procedurave të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave; ndihmë financiare, në masën e 1 page mujore, sipas pagës referuese, çdo përvjetor vdekjeje; ceremonia mortore organizohet nga drejtuesi i strukturës dhe shpenzimet paguhen nga buxheti i policisë; punësim me prioritet në përputhje me arsimimin, përvojën dhe kritere të tjera të nevojshme për vendin e punës. Në vitin 2024 është miratuar ligji i ri i posaçëm nr. 82/2024, i cili ka shfuqizuar ligjin nr. 108/2014. Në nenin 111 të këtij ligji janë parashikuar të njëjtat përfitime dhe trajtim për familjarët e punonjësve të policisë që humbin jetën për shkak të detyrës.

4. Duke iu referuar përmbajtjes së ankimit kushtetues individual, rezulton që fëmijët e të ndjerit G. Zh. të mos kenë përfituar nga ligji. Me pretendimin se fëmijët e saj nuk përfshihen në parashikimet ligjore, pasi nuk ka ndonjë parashikim të shprehur për punonjësit që humbin

jetën aksidentalisht në detyrë (ekziston boshllëk ligjor), kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual.

5. Shumica, në vlerësimin e kriterëve paraprake të legjitimitetit të kërkueses, ka arritur në përfundimin se ajo nuk ka parashtruar dhe argumentuar nëse për ish-bashkëshortin është njohur ose refuzuar statusi i “të rënit në detyrë”, pra nuk ka paraqitur një akt individual negativ (ndalues) dhe, në vijim, nëse ajo ka pasur ose jo mjete në dispozicion për të kundërshtuar një akt të tillë administrativ me mjetet ligjore të ankimit që njeh legjislacioni në fuqi, apo nëse këto mjete ligjore ka qenë joefektive. Sipas shumicës, ndonëse *prima facie* duket se ligji i kundërshtuar ka një parashikim ndalues për rastin e kërkueses, i cili mund të kufizojë të drejtat e pretenduara prej saj dhe fëmijëve të mitur, u takon, në radhë të parë, autoriteteve ligjzbatuese dhe, më tej, gjykatave të juridiksionit të zakonshëm që të interpretojnë e të zbatojnë dispozitat e ligjit nr. 82/2024 dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi, duke pasur në vëmendje qëllimin për miratimin e këtyre dispozitave dhe rrethanat e rastit konkret, përfshirë edhe situatën e gjendjen ekonomike, shëndetësore e sociale, si dhe nevojat e veçanta të kërkueses (shih paragrafin 13 të vendimit).

6. Gjykata ka theksuar se, për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, kërkuesja duhet t’i ketë përdorur të gjitha mjetet juridike efektive në dispozicion për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese që cenon ligji i kundërshtuar jo vetëm formalisht, por edhe në kuptimin substancial. Si rregull, ligji zbatohet përmes akteve të organeve publike ose vendimeve gjyqësore, prandaj individi duhet, së pari, t’i kundërshtojë ato përpara gjykatave kompetente, duke shteruar të gjitha mjetet juridike që parashikon sistemi ynë juridik. Kjo ka rëndësi edhe për të provuar se kërkuesi është prekur personalisht, drejtpërdrejt dhe realisht. Megjithatë, ligji ka parashikuar edhe rastet kur përmbushja e këtij kriteri është e pamundur (legjislacioni nuk parashikon mjete juridike ose ato janë joefektive). Meqenëse mjeti juridik mund të jetë i ndryshëm, në varësi të llojit të ankimit, efektiviteti i tij vlerësohet jo thjesht nga fakti që është parashikuar me ligj, por edhe nga zbatueshmëria e tij (shih vendimin nr.31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese).

7. Mbi bazën e këtij standardi, ne, gjyqtarët në pakicë, ndajmë qëndrim të ndryshëm nga shumica për kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive. Në vlerësimin tonë, edhe pse pika 2 e nenit 111 të ligjit i ka deleguar Këshillit të Ministrave rregullimin me VKM të procedurave të trajtimit të familjarëve të punonjësve, që humbin jetën për shkak të detyrës, pasojat antikushtetuese të pretenduara në fakt vijnë nga përmbajtja e pikës 1 të këtij neni që ka

parashikuar shprehimisht përfitimin e këtij trajtimi të posaçëm vetëm për familjarët e të rënit në detyrë, ndërkohë që në rastin konkret është e qartë se kur ka humbur jetën i ndjeri (bashkëshorti i kërkueses) nuk ka qenë *de facto* në ushtrim të detyrës, por e kishte përfunduar atë. Në këtë kuptim, siç edhe ka pretenduar kërkuesja, antikushtetutshmëria e normës vjen pikërisht për shkak të mosparashikimit në të edhe të kategorisë së familjarëve të punonjësve të policisë që humbin jetën për shkaqe të tjera, edhe aksidentalisht, por që gjithsesi shkak i humbjes së jetës është i lidhur me detyrën, pasi i ndjeri është aksidentuar menjëherë pas lënies së turnit (detyrës), siç në rastin konkret bëhet fjalë për kthimin në vendin e banimit me automjet personal pas 20 orëve të punës pa ndërprerje. Për rrjedhojë, në rastin konkret, kërkuesja nuk ka asnjë mjet tjetër efektiv në dispozicion, ndërkohë që çdo kërkesë drejtuar organeve shtetërore ose gjykatës do të rezultonte e pasuksesshme, për rrjedhojë do të ishte një mjet joefektiv në mungesë të parashikimit ligjor të zbatueshëm. Në këtë kuptim, kërkueses nuk mund t'i kërkohet të shterojë mjete juridike të tilla, që nuk do të ishin të afta të riparoheshin ose të rivendoseshin shkeljen e riparuar. Për më tepër, kërkuesja ka argumentuar se ajo i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe ka marrë përgjigje negative për zbatueshmërinë e ligjit të mëparshëm, shkak për të cilin ajo dhe i ati i ish-bashkëshortit të ndjerë (vjeherri i saj) u janë drejtuar disa institucioneve dhe përfaqësuesve të tyre, ashtu edhe deputetëve, të cilët kanë marrë shqetësimin e tyre, por kjo çështje nuk është riparuar as në ligjin e ri.

8. Në këto kushte, kërkuesja nuk ka mjete të tjera në dispozicion për të shteruar përveç paraqitjes së kërkesës për kontrollin e pajtueshmërisë së normës ligjore me Kushtetutën, pra paraqitjes së ankimit kushtetues individual për rivendosjen e të drejtave të pretenduara të cenuara.

9. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar domosdoshmëria që paraqet për funksionimin normal të shtetit të së drejtës, shmangia e boshllëkut ligjor, pasi ekzistenca e ometimit ligjor sjell cenimin e parimeve kushtetuese dhe, në këtë mënyrë, është detyrë e ligjvënësit ta plotësojë këtë boshllëk në të ardhmen (*shih vendimet nr. 75, datë 19.04.2002; nr. 76, datë 25.04.2002; nr. 5, datë 27.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë këndvështrim, në rast se vërtetohet se shkelja e një të drejte ose lirie kushtetuese themelore nuk ka ardhur si pasojë e përmbajtjes së normës ligjore, por për shkak të mosveprimit të ligjvënësit për rregullimin e një çështjeje të caktuar, Gjykata, në rolin e saj, jo vetëm konstaton boshllëkun, por në përputhje me nenin 76, pika 5, të ligjit nr. 8577/2000, vendos detyrimin e ligjvënësit për të plotësuar kuadrin ligjor brenda një afati të caktuar.

10. Për sa më sipër, ne, gjyqtarët në pakicë, jemi të qëndrimit se kërkesja nuk ka mjete të tjera në dispozicion për të shteruar përveç paraqitjes së kërkesës për kontrollin e pajtueshmërisë së normës ligjore me Kushtetutën, pra paraqitjes së ankimit kushtetues individual për rivendosjen e të drejtave të pretenduara të cenuara. Për më tepër, ne vlerësojmë se edhe në këndvështrim të legjitimitetit *ratione materiae* pretendimet e kërkuases nuk janë haptazi të pabazuara, pasi ajo ka provuar pasojat negative për shkak të boshllëkut ligjor në dispozitën e nenit 111 të ligjit nr. 82/2024.

11. Në përfundim, për sa sipër, çmojmë se në rastin konkret duhej të ishte vendosur kalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

Anëtarë: Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Sandër Beci